

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

14.02.2025  
Ora, 10:18

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |       |                     |
|------------|-------|---------------------|
| • Ilirjana | NANO  | Kryetar             |
| • Arens    | ÇELA  | Anëtar              |
| • Dritan   | ÇAKA  | Anëtar              |
| • Helga    | VUKAJ | Anëtar              |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar              |
| • Stafi    | KQZ   | P. Doçaj, B. Kodra. |

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: KRIIK

*Znj. I. Nano:* Mirëmëngjes! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në mbledhjen e ditës së sotme kemi një çështje në rendin e ditës “Miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*


banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Çështje jashtë rendit të ditës keni kolegë? po zoti Nuri!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Çështjen që nuk pata mundësi ta diskutoja dje, do ta bëj sot.

**Znj. I. Nano:** Zonja Xhina? Po! Mirë, fillojmë me shqyrtimin e këtij projektvendimi. Siç jeni në dijeni, ne javën e kaluar kemi miratuar karakteristikat teknike të fletës së votimit që përdoret brenda vendit, sot është momenti të miratojmë karakteristikat teknike të fletës jashtë vendit. Do të lutesha, zonja Doçaj një relativitet të shkurtër lidhur me këtë projektvendim.

**Znj. P. Doçaj:** Projektvendimi “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Referuar nenit 97, pika 1 parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore. Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë qarkun dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (QR code). Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhen këtij projektvendimi. Duke qenë se tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar për karakteristikat teknike të fletëve të votimit të përdorura dhe në zgjedhjet pararendëse, do të propozohen më poshtë edhe disa specifikime

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

teknike të përdorura në zgjedhjet e mëparshme. Elementë të veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit jashtë territorit të RSH. Në referim të nenit 25/1, pika 2, ne propozojmë disa elementë të veçantë dallues të kësaj flete votimi, pra të votuesve jashtë territorit të Shqipërisë që është si më poshtë:

Kreu i fletës së votimit ku vendosen elementët e përgjithshëm të fletës së votimit do të jetë pa ngjyrë. Do të jetë një shirit i bardhë me lartësi 30 mm. Kjo fletë votimi do të emërtohet “ FLETË VOTIMI NGA JASHTË”. Ky është elementi dallues i fletës së votimit nga jashtë, nga ai i fletës së votimit për votuesit brenda vendit. Nisur nga sa më sipër, propozojmë për shqyrtim dhe miratimin tuaj, projektvendimin, “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për votuesit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Doçaj! Fillojmë diskutimet në parim. Kolegë, kemi diçka në parim për fletën e votimit? Jo! Nga përfaqësuesit e partive politike, në parim, ka diçka? Jo! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë fillojmë nen për nen, pikë për pikë! Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Për të miratuar pikën 1 do të duhet të kalojmë te lidhja 1, ku është përmbajtja e kësaj pike.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

Lidhja 1.

Disa karakteristika të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Nëse është e mundur grafikisht ta kemi propozimin tuaj?!

Atëherë, lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m<sup>2</sup>, 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me trashësi 117 micron, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm.

Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 420 mm.

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra;

Logo KQZ, me ngjyra;

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës (CMYK) dhe kemi përqindjet e secilit komponent të kësaj ngjyre.

QR kodi, elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve:


Qarku 2 shifra, elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit.

Qarku, elementë të veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit nga jashtë territorit të RSH do të jetë si vijon:

Kreu i fletës së votimit ku vendosen elementët e përgjithshëm të fletës së votimit do të jetë pa ngjyrë (e bardhë) me lartësi 30 mm, kjo fletë votimi emërtohet “FLETË VOTIMI NGA JASHTË”.

Pra, e kemi dhe të paraqitur në monitor. Ngjyra e fletës së votimit është e njejtë me atë brenda vendit, duke respektuar dhe parashikimet e Kodit Zgjedhor. Kemi një shirit lart ku vendosen këto elementë të lexueshëm. Atëherë, nëse ka diçka për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

lidhjen 1? Unë do të thoja vetëm, këtu ku thuhet “fletë votimi pa ngjyrë”, “e pa ngjyrosur”, nuk ka nevojë ta votojmë besoj?! Nëse keni për të diskutuar kolegë?  
Zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, për sa u relatua dhe ju lexuat përmbajtjen e këtij propozimi të ri, kujtoj thjesht arsyen se pse e kthyem këtë fletë votimi për t’u rimodeluar, edhe njëherë, apo për t’u rivlerësuar edhe një herë, për sa i përket elementit dallues që duhet të ketë kjo fletë votimi. Në këtë përmbajtje, unë nuk e gjej në fakt elementin dallues, i cili të qaset me faktin e të qënit evident dhe cilësi ndihmëse për numëruesin që nuk do të numërojë vetëm në fashën kohore të ditës, por edhe natën. Kështu që në këtë kuadër, unë do të sjell propozim konkret në lidhje me elementin dallues se si e mendoj unë dhe kam dakordësinë e kolegut Çakaj, në lidhje me fletën e votimit nga jashtë, e cila domosdoshmërisht mendojmë se duhet t’i ketë këto elementë dallues në pjesën e pasme të fletës. Nëse doni që unë të bëj propozimin konkretisht, do të thoja që në fjalinë e cila përcakton ngjyrën e fletës së votimit, që të bëjmë dallimin me fletën nga pas, do të shtoja “Ngjyra e fletës së votimit përpara..”, edhe aty janë dy pikat dhe përcaktohet në këtë rast kodi, siç e shihni dhe ju, për sa kohë është i njëjtë me fletën e votimit nga brenda, duhet të mbetet i njëjtë dhe këtu do të vemë elementin dallues që ne dy kolegët, unë dhe zoti Çakaj, mendojmë që të ketë fleta e votimit nga jashtë. Duhet të jenë dy shirita që të kenë një ngjyrë evidente ndihmuese. Propozimi ynë është që ngjyra nga pas e fletës, direkt pas kësaj fjalie të fillojë, “Fleta në pjesën e pasme të saj të ketë si element dallues dy shirita vertikale me gjerësi 40 mm secili me ngjyrë të kaltër”. Variantin që propozojmë ia kemi dhënë administratës, por që në kod zërthehet C70% M0% Y31% K0%. Ky është propozimi ynë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

**Znj. I. Nano:** Sipas propozimit tuaj, kjo do të jetë pjesa e pasme e fletës së votimit nga jashtë?

**Znj. H. Vukaj:** Po! Pjesa e përparme është po e njejta, thjesht shtohet një fjalë pas fjalisë ekzistuese, përpara.

**Znj. I. Nano:** Po, zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Vlen të evidentojmë faktin, se në respekt të nenit 97 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se ngjyra e fletës së votimit është e njejte si brenda dhe jashtë. Faqja e parë e fletës së votimit do të jetë ekzaktësisht si për votuesit nga brenda dhe për votuesit nga jashtë. Ndërkohë nuk mund të konsiderohet element i veçantë dallues, thjesht identifikimi “fletë votimi nga brenda” dhe “fletë votimi nga jashtë” dhe në këto kushte së bashku me kolegen Vukaj, propozimi ynë është që elementi i veçantë dallues, edhe për lehtësi të numërimit, edhe për lehtësi të evidentimit të fletëve të votimit nga jashtë, të jetë pikërisht në faqen e pasme me dy shirita, kodin e tha kolegja, në të dy anët në mënyrë që edhe kur të paloset fleta e votimit, të identifikohet që bëhet fjalë për një fletë votimi nga jashtë. Konkretisht ky është propozimi im. Kjo duhet të jetë fleta e votimit nga jashtë, elementi i veçantë, pjesa e pasme. Pjesa e përparme të jetë ekzaktësisht si fleta e votimit nga brenda, siç është propozuar nga komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Znj. I. Nano:** Zoti Çaka!

**Z. D. Çaka:** Faleminderit zonja Nano! Personalisht e shoh të vlefshëm propozimin e dy kolegëve dhe vlerësoj se vërtet është një element dallues në raport me fletën e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

votimit që ne kemi miratuar për brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte nëse do të votohet me shumicë votash nga ky komision, ky propozim i kolegëve, do të kisha dhe unë një propozim. Pra, ky është një element i veçantë i fletës së votimit. Ndërkohë, që propozimi që ju keni sjellë ku thuhet te kreu i fletës së votimit, të mos jetë pjesë e një elementi të veçantë, se po themi që është pjesë integrale e pjesës së përparme të fletës. Jam dakord dhe me diskutimin e kolegut Çakaj që thjesht termi “fletë votimi nga jashtë”, nuk mund të përbëjë një element dallues. Ndaj do të propozoja që ky paragraf të spostohej menjëherë si renditje pas ngjyrës së fletës së votimit dhe element i veçantë të ishte propozimi i kolegëve. Kuptohet, nëse kjo do të jetë pastaj, nëse kolegët janë dakord, një bashkëpropozim për t’u kaluar në mënyrë unanime si votim. Faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Mund ta marr pak fletën e votimit, atë që keni propozuar? Atëherë, pa dyshim që sipas kodit, ne duhet të kemi një element dallues. Edhe me kolegët që po bëjnë propozimin është diskutuar që një fletë e tillë, nëse paloset shumë herë, përsëri bëhet e dallueshme, nuk e humbet këtë element. Nëse do të ishte një shirit në qendër, mundet edhe të humbiste ky element dallues, por dy shirita anësore janë të dallueshme në çdo formë që paloset.

**Znj. H. Vukaj:** Kjo ishte dhe arsyeja që në çdo formë që mund të paloset, kjo të jetë e evidente dhe e dukshme. Pra, si do që ta palosësh, edhe në forma të tjera, ne e dimë se si paloset një fletë votimi. Kjo është forma klasike, por kjo është e evidente dhe nuk i humbet sensi për atë që ne propozojmë. Unë një pyetje të vogël kam për administratën. Nuk besoj se do të ketë ndonjë kosto shtesë, apo ekstra për këtë propozim tonin, edhe është e realizueshme?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

**Z. B. Kodra:** Nga ana teknike është e realizueshme dhe nuk besoj se ka.., ka një kosto minimale shtimi i ngjyrës, por jo ndonjë që afekton në vlerësimin tim.

**Znj. I. Nano:** Në çdo rast në zbatim të kodit duhet të kishte një element dallues dhe ky ishte një element që vërtet është i tillë. Atëhere, që të votojmë Lidhjen 1, integrojmë propozimet e dy kolegëve Çakaj, Vukaj dhe zotit Çaka. Pra, pas “Ngjyra e fletës së votimit” do të shtohet fjalia “Kreu i fletës së votimit” ku vendosëm që elementë të përgjithshëm do të jetë “E pangjyrosur, e bardhë, me lartësi 30 mm. Kjo fletë votimi emërtohet “Fletë votimi nga jashtë”. Kalon këtu dhe tek “Elementë të lexueshëm”, pas fjalisë “Elementë të veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit jashtë territorit të RSH do të jetë si vijon: fleta në pjesën e pasme të saj të ketë elementë dallues dy shirita vertikale me gjerësi 40 mm secili, me ngjyrë me kod C70% M0% Y31% K0%”. Kolegë e votojmë këtë propozim të Lidhjes 1, rrjedhimisht pikën 1, të projektvendimit?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, sikurse dhe në fletën e votimit brenda vendit, por dhe në vite të tjera kur kemi miratuar karakteristikat e fletës së votimit, vijmë te përmasat e fletës së votimit. Pra, pika 2. Përmasat e fletës së votimit, përcaktohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen.


**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

***Kundër:*** s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

***Kundër:*** s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

***Kundër:*** s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi ka pësuar edhe disa ndryshime, sikundër e ndoqët. Edhe njëherë dakordësinë tuaj kolegë.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

***Kundër:*** s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Mbaruam shqyrtimin e projektvendimit, çështje tjetër në rendin e ditës nuk kemi.

**Vendimi nr. 7**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

14.02.2025  
Ora, 10:34

**JASHTË RENDIT TË DITËS**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |                             |
|------------|-----------|-----------------------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar                     |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar                      |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar                      |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar                      |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar                      |
| • Stafi    | KQZ       | P. Doçaj, B. Kodra.         |
| Parti      | Politike: | PD (F. Nuri), PS (E. Xhina) |
| OJQ:       |           | KRIIK                       |

*Znj. I. Nano:* Vazhdojmë me çështje jashtë rendit të ditës. Zoti Nuri, zonja Xhina.  
Fillojmë me zotin Nuri!

*Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:* Po faleminderit zonja Kryetare. Edhe ne jemi dakord me miratimin e këtyre ndryshimeve, patjetër. Bëjnë pjesë të parashikimet e kodit për të dalluar në rradhë të parë, fletën e votimit nga jashtë...

*Znj. I. Nano:* Edhe ngjyra është e bukur, apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Po, edhe ngjyra është e bukur, e kaltër që afrohet me ngjyrat tona, nuk diskutohet.

**Znj. I. Nano:** Tani në qoftë se kjo afrohet me ngjyrat tuaja, kjo paska qenë një rastësi e çuditshme, se kolegët nuk besoj se kanë pasur parasysh ngjyrat tuaja.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Për jashtë rendit të ditës, unë e kisha shqetësimin, e nderuar zonja Kryetare, në lidhje me qëndrimin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të mbante në lidhje me atë që media investigative nxorri para pak ditësh dhe bëri publike në lidhje me regjistrimin e diasporës nga persona të pa autorizuar dhe që pretendonin që vepronin në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është e vërtetë që ditën e djelë pati një reagim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ku u bë një distancim në këtë kuptim që KQZ-ja nuk ka autorizuar askënd që të bëjë regjistrime në terren. Ne do të kërkonim si Parti Demokratike, që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, KQZ-ja të ndërmernte hapa më të fortë në këtë drejtim. Pse jo, meqenëse u bë dhe publike si rast, të vepronte me kallëzim përkatës penal, meqenëse dhe dje u bë publik lajmi i bashkëpunimit të KQZ-së me SPAK-un. Gjithashtu dhe lidhja e memorandumit të bashkëpunimit ku dhe para dy ditësh pati një dakordësi nga ana e institucionit të KQZ edhe me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës, pikërisht në lidhje me shkeljet dhe krimet zgjedhore. Edhe njëherë gjej rastin për të bërë këtë apel që ne si Parti Demokratike i kushtojmë një vëmendje të veçantë dhe të rëndësishme të gjithë problematikës së shkeljeve zgjedhore dhe krimeve zgjedhore. Gjithashtu do të donim që, KQZ-ja të ishte në lartësinë e duhur si institucion, në lidhje me këtë tematikë dhe të mos hezitojë vetë institucioni kryesisht, kur sheh dhe bie në dijeni të rasteve të ngjashme, duhet të bëjë kallzime penale me iniciativën e tij. Patjetër që ne si subjekt politik kemi sjellë denoncime në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

lidhje me shkeljet administrative në KQZ, për aq sa kodi e lejon dhe jemi duke sjellë dhe denoncime të tjera. Presim mbledhjen më të afërt për t'i diskutuar ato, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Nuri! Padyshim që këto thirrje mund t'i drejtoni kurdo herë, në cilado mbledhje të organeve të KQZ-së, posaçërisht ndoshta në mbledhjet e Komisionerit. Madje edhe për kallëzim penal, unë besoj që duke qenë një shqetësim i ngritur kaq herë nga ana juaj, nuk besoj se ju pengon askush të bëni vetë një kallëzim penal. Zonja Xhina!

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Faleminderit! Gjithashtu dhe unë dua të shpreh falenderime që ne sot përfundimisht arritëm të miratonim fletën e votimit për zgjedhësit nga jashtë. Gjithashtu, jam shumë dakord edhe me elementin shtesë që vihet për t'u dalluar. Edhe për mua, ngjyra është e pranueshme, larg ngjyrymeve politike. Sa i takon çështjeve jashtë rendit të ditës, çuditërisht edhe unë si kolegu, kam të njejtën thirrje për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kam konstatuar në fakt, që në shumë raste janë bërë denoncime edhe pa referime në Kodin Zgjedhor, ç'ka e ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në shumë raste pa një objekt të caktuar, duke e detyruar të pushojë çështjet. Ndaj bëj thirrje që të ndërgjegjësohen të gjithë ata që bëjnë denoncime, që rastet të jenë të referuara, të bazuara në Kodin Zgjedhor, në dispozitat specifike të tij. Gjithashtu edhe në aktet që vetë KQZ-ja, ka miratuar në si akte nënligjore, specifikisht Komisioni Rregullator dhe pse jo, të mendohet që rastet që vihen kot në lëvizje dhe që janë të përsëritura, ndoshta duhet të ketë një ndëshkim administrativ, pasi venë në lëvizje gjithë administratën. Sa i takon rastit që kolegu sapo relatoi është një rast që u ngrit edhe dje në diskutimin tonë. Jemi shumë dakord që rasti të ndiqet, por që të ndiqet

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 14.02.2025*

specifikisht, sepse normalisht nuk mund të nisemi vetëm nga denoncime që bëhen në media nga një figurë e caktuar, por duhet ndjekur si personi është prezantuar dhe nëse vërtet situata ka qenë e tillë, sigurisht që duhet të marrë ndëshkimin sipas Kodit Zgjedhor dhe atij Penal, faleminderit.

*Znj. I. Nano:* Faleminderit, zonja Xhina! Edhe diskutimi i juaj dhe i zotit Nuri jashtë rendit të ditës, unë mendoj që dëshmon ngrohtësinë që ndjeni pranë Komisionit Rregullator për të ngritur gjithë çështjet që lidhen me organet e tjera. Jeni të mirëpritur në çdo seancë. E mbyllim mbledhjen, s'kemi çështje të tjera, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

